



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

CIMC- 2007/01

Në pajtim më nenin 16.1 të ligjit Nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media mori:

Vendim

për nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës së taksës për Licencim të
Radios dhe TV-së

Neni 1

Përmbajtja e Vendimit

Ky vendim do të rregullojë:

1.1. Nivelin e taksës së vetme për procesim të aplikacioneve në lidhje me tenderin për licencë të transmetimit analog tokësor të sinjaleve të radios dhe televizionit.

1.2. Nivelin e taksës së vetme për aktivitetet në lidhje me regjistrimin e një aplikuesi për lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës për transmetim analog tokësor dhe/ose transmetim të sinjaleve të radios dhe televizionit.

1.3 Nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës së taksës vjetore për licencë analoge tokësore dhe transmetim të sinjaleve të radios dhe televizionit.

1.4 Niveli i taksës së vetme për operatorët kabllor dhe për transmetim digjital do të rregullohet me vendime të veçanta.

Neni 2

Niveli i taksës së vetme për procesimin e aplikacioneve në tender

2.1 Taksa e vetme do të ngarkohet për procesim të aplikacioneve në tender, niveli i të cilës do të përcaktohet sipas llojit të aktivitetit të transmetimit dhe madhësisë së zonës ku ushtrohet aktiviteti.

2.2. Një taksë e vetme për procesim të aplikacioneve në tender do t'i paguhet Komisionit të Pavarur për Media gjatë paraqitjes së aplikacionit në tender, pa mundësi të kthimit të taksës.

2.3 Niveli i taksës së licencimit për procesim të aplikacioneve në tender do të përcaktohet me një vendim të veçantë.

Neni 3

Niveli i taksës së vetme të regjistrimit

3.1 Një taksë e vetme për regjistrim të personit fizik apo juridik i cili ka fituar të drejtën për transmetim, si edhe personat të cilët i vazhdojnë licencat e tyre do të ngarkohen sipas shpenzimeve të dhënies së licencës për transmetim, ekzaminimit teknik dhe regjistrimit nga Komisioni i Pavarur për Media.

Niveli i taksës së vetme të regjistrimit është për:

Radio: 10% e taksës vjetore

Televizion: 10% e taksës vjetore

3.2 Gjatë paraqitjes së aplikacionit për licencë të përkohshme, do të paguhet një taksë në vlerë prej 10% të taksës së vetme të regjistrimit.

3.3 Gjatë paraqitjes së aplikacionit, një taksë e vetme e regjistrimit do t'i paguhet Komisionit të Pavarur për Media, pa mundësi të kthimit.

Neni 4

Niveli i Taksës Vjetore

Taksa Vjetore për transmetim të sinjaleve të radios dhe televizionit do të përcaktohet në bazë të:

- Zonës së mbulueshmërisë dhe atraktivitetit të saj ekonomik;
- Popullatës në atë zonë;
- Karakterit të programit.

Neni 5

Niveli i taksës mujore

Taksa mujore për licencë të transmetimit për sinjalet e radios dhe televizionit do të përcaktohet në mënyrën e mëposhtme:

$I = A \times B \times C \times D - E$, ku:

A – është vlera € 50.00 për televizionet dhe radiot me mbulim mbarë kosovar;

€ 40.00 për subjektet transmetuese tjera

B – është koeficienti i cili, varësisht prej numrit të popullatës në zonën e mbuluar të radio/televizionit i cili përdorë frekuencë komerciale të transmetimit nga një pozitë, llogaritet:

- 1,00 për zonë të mbuluar me më pak së 10.000 qytetarë;
- 1,25 për zonë të mbuluar me 10.000 deri 50.000 qytetarë;
- 1,50 për zonë të mbuluar me 50.000 deri 150.000 qytetarë;
- 1,75 për zonë të mbuluar me 150.000 deri 300.000 qytetarë;
- 3,00 për zonë të mbuluar me 300.000 deri 800.000 qytetarë;
- 6,00 për zonë të mbuluar me mbi 800.000 qytetarë.

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

C – është koeficienti i cili varësisht prej atraktivitetit ekonomik të zonës, llogaritet:

- a) 0,75 për komunën e Novobërdës, Shtërpçës, Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut, Shtimes, Glllogocit, Skenderajt;
- b) 1,00 për komunën e Kamenicës, Deçanit, Malishevës, Istogut, Klinës, Podujevës, Obiliqit, Rahovecit, Vitisë, Suharekës, Kaçanikut, Vushtrrisë, Lipjanit, Fushë Kosovës, Dragashit;
- c) 1,50 për komunën e Ferizajt, Prizrenit, Pejës, Mitrovicës, Gjilanit, Gjakovës;
- d) 1,75 për komunën e Prishtinës;
- e) 7 për mbulim mbarë Kosovës.

Nëse dy apo më shumë komuna të niveleve të ndryshme të atraktivitetit mbulohen nga një pozitë, do të merret koeficienti i komunës më atraktive.

Koeficienti C për komunat e reja që mund të krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të caktohet me vendim të veçantë.

D – është koeficienti i cili, varësisht nga lloji i subjektit transmetues, llogaritet:

- a) 1,00 për programet e radios;
- b) 1,50 për programet televizive.

E – është koeficienti i cili reflekton zbritjen në përqindje të taksës së licencës për subjektet transmetuese komerciale të cilat transmetojnë programe specifike në gjuhë të minoriteteve dhe/ose programe të caktuara të shërbimit publik (për shembull lajmet, programet informative, kulturore, edukative):

- a) 5% për së paku 60 minuta në javë në një gjuhë dytësore me jo më pak se 30% përmbajtje informative.
- b) 20% për subjektet transmetuese gjuha kryesore e të cilave është gjuha e minoritetit në zonën në të cilën shërbejnë.
- c) 5% për së paku 20 për qind / 10% për së paku 30 për qind të programit lokal dhe/ose programit të vetë prodhuar me karakter të shërbimit publik (lajme, programe informative, kulturore, edukative, duke përjashtuar muzikën).

Të gjitha përqindjet që zbriten nga taksa e licencës për të cilat subjekti transmetues kualifikohet do të mblidhen.

Neni 6

Mënyra e pagesës së taksës

6.1. Taksat do të paguhen çdo muaj në 12 pjesë të barabarta (1/12 e taksës vjetore), dhe taksa e parë mujore do të paguhet gjatë marrjes së licencës për radio/televizion i cili fillon me transmetimin e programit, përfshirë muajin kur licenca është lëshuar.

6.2. Taksa mujore për lëshimin e licencës për transmetim të sinjaleve radio dhe televizive do të paguhet në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media jo më vonë se i 5-ti i muajit aktual.

6.3. Në rast se subjektet transmetuese nuk e informojnë Komisionin e Pavarur për Media se nuk planifikon të transmetojnë më program, përgjegjësitë e ndërmarra financiare nga licenca do të jenë valide deri në momentin e kur KPM pranon njoftimin me shkrim.

6.4. Nëse mbajtësi i licencës ndalon së transmetuari sinjalet e radios dhe televizionit para skadimit të kohës për të cilën kohë taksa është paguar, pjesa e mbetur e taksës nuk do të kthehet.

6.5. Nëse është vendosur se i licencuari ka transmetuar jashtë zonës së mbulimit të caktuar në licencën e tij, KPM retroaktivisht mund t'i caktojë të licencuarit (dyfish) vlerën e taksës që ai do të paguante për zonën e tij të pa-licencuar nëse ai mbulim i zonës do të përcaktohej në licencën e tij. Kjo nuk do të kuptohet si e drejtë për transmetim jashtë zonës së mbulimit të përcaktuar me licencë. Kjo pagesë është shtesë e çdo sanksioni që KPM mund të vendosë.

6.6. Në rast të pagesës me vonesë të taksës se referuar në paragrafin 2 të këtij neni, personi me licencën e lëshuar për transmetim të sinjaleve të radios dhe televizionit do të paguajë kamatë për vonesë të pagimit të taksës.

6.7. Niveli i kamatës do të caktohet sipas nivelit të kamatës që e aplikon Administrata Tatimore e Kosovës për vonesa në pagimin e tatimit.

6.8. Kamata do të llogaritet në bazë mujore, për çdo muaj apo pjesë të muajit nga data kur taksa është bërë e detyrueshme për pagesë deri në datën kur taksa paguhet.

6.9. Mospagimi i taksës së licencës do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë në revokimin e licencës.

Neni 7

Taksa për Licencë të Përkohshme

Taksa për licencë të përkohshme do të përcaktohet në pajtim me këtë vendim dhe do të paguhet paraprakisht para lëshimit të licencës për të gjithë periudhën e licencimit.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi më 1 maj 2007.

Isuf Berisha

Kryetar i Këshillit të KPM-së

Datë